



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201602211/8

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2017

**Lënda :** *Rekomandim për trajtimin dhe marrjen e masave teknike dhe ligjore për zgjidhjen e problematikave që ngrihen në ankesën e shtetas Sh.M dhe disa banorëve në lagjen "Afrimi i Ri", Rruga e Semanit (SMT-ja), Fier.*

**Drejtuar :** **Kryetar i Bashkisë**  
**Z. Armando Subashi**

**FIER**

**Këshillit Bashkiak**  
**Kryetarit**

**FIER**

**Për dijeni:** **Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t**  
**Drejtorit**

**FIER**

*I nderuar z. Kryetar,*

Sikurse ju kemi bërë me dije përmes korespondencës zyrtare, shtetasja Sh.M në emër edhe të 22 familjeve që banojnë në lagjen "Afrimi i Ri", Rruga e Semanit (SMT-ja), janë drejtuar me ankesë Institucionit të Avokatit të Popullit, në lidhje me mosveprimin e strukturave përgjegjëse në Bashkinë Fier për parandalimin e një situatë të rëndë të krijuar në këtë zonë, si rezultat i ndërtimeve pa kriter të kryera kryesisht mbi kolektorin kryesor të shkarkimit të ujrave dhe kanalit vaditës që kalojnë pranë banesave të këtyre banorëve. Kjo situatë sipas banorëve, ka sjellë si pasojë bllokimin e sistemit të kanalizimeve për shkarkimin dhe kullimin e ujrave, daljen nga shtrati të ujrave dhe përmytjen herë pas here të kësaj zone, duke rrezikuar jetën, shëndetin, si dhe duke dëmtuar shtëpitë e banimit dhe tokën bujqësore në pronësi të tyre.

Më konkretisht, shtetase Sh.M është pronare e pasurisë me nr.70/20, ZK 1003 sipas Certifikatës të pronësisë lëshuar nga ZVRPP Fier, më datë 10.04.2009. Po ashtu, edhe banorët e tjerë të kësaj zone (bashkëngjitur kësaj ankese), sipas skicës të Planvendosjes të tokës për parcelën Nr.70 në fshatin "Afrim i Ri" e konfirmuar nga ish-Komuna Qëndër, Fier, kopje e të cilës është depozituar pranë Institucionit tonë, rezultojnë të jenë pronarë të tokave bujqësore, sipas parcelave respektive.

Sikundër shprehen në ankesë dhe nga dokumentacioni shoqërues i saj, shtetasja Sh.M dhe 22 banorë të tjerë që banojnë në këtë lagje, përmes një peticioni të firmosur prej tyre, janë drejtuar me ankesa në mënyrë të përsëritur nga viti 2016 dhe në vijim organit të qeverisjes

vendore, Bashkia Fier. Por, ata pretendojnë se, nga ana institucioneve që përgjigjen për verifikimin dhe trajtimin e këtij rasti, ka patur vetëm disa reagime sporadike dhe përgjigje shkresore, duke u mjaftuar me konstatimin e kësaj situatë dhe duke pranuar që problemet e ngritura nga këta qytetarë ekzistojnë, por deri sot nga ana e tyre nuk është marrë asnjë masë konkrete për ndryshimin e kësaj situatë që paraqitet mjaft serioze për familjet dhe pronat e ligjshme të këtyre banorëve.

Në këto kushte, shtetasja Sh.M është drejtuar me ankesë Institucionit të Avokatit të Popullit, ku kërkohet ndërhyrja pranë Bashkisë Fier, për ndërmjetësimin në trajtimin e rastit dhe marrjen e masave të menjëhershme për zgjidhjen e këtij shqetësimi.

Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në kompetencat që jep Ligji Nr. 8454 datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, me shkresë Nr.K3/Sh-76-2 prot., datë 09.12.2016 jemi drejtuar IMT, Policia Bashkiake, Ndërmarrja e Ujitjes dhe Kullimit në Bashkia Fier, me kërkesën për informacion dhe dhënien e shpjegimeve në lidhje me shqetësimin e prezantuar nga shtetasja Shpëtime Mone dhe banorët e lagjes *“Afrim i Ri”*. Por, nga ana e këtyre institucioneve fillimisht nuk pati asnjë reagim apo përgjigje zyrtare drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Në muajin Mars 2017, shtetasja Sh.M ka përsëritur ankesën e saj pranë Institucionit tonë shoqëruar me dokumentacion shtesë që vërteton pronësinë për pronën e saj dhe banorëve të tjerë në këto prona. Në ankesë, banorët denoncojnë njëkohësisht paligjshmërinë dhe papërgjegjshmërinë e disa subjekteve që kanë kryer ndërtime informale (mure rrethues) mbi kolektorin kryesor të shkarkimit të ujrave dhe kanalën vaditës që përshkon këtë lagje dhe si pasojë mosfunksionimin e sistemit të kullimit të ujrave, duke shkaktuar përmbytje dhe dëme të konsiderueshëm në pronat e tyre të ligjshme. Gjithashtu, ata ngrenë shqetësimin e përsëritur, për mosveprimin e strukturave shtetërore që përgjigjen me ligj në Bashkia Fier, për parandalimin e këtyre ndërtimeve pa leje, si dhe për mosmarrjen e masave në kohë për prishjen e tyre.

Sa më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit me shkresë Nr.K3/Sh76-5 Prot., datë 07.07.2017 ju drejtua organit epror, Kryetarit të Bashkisë Fier, me kërkesën e përsëritur për dhënien e informacionit dhe shpjegimeve në lidhje me arsyet që justifikojnë mosveprimin e këtyre institucioneve për situatën e paraqitur nga këta banorë, si dhe për mosmarrjen e masave ndaj përgjegjësve që kanë shkaktuar një situatë të tillë, që cënon sigurinë e jetës dhe të pronave të banorëve të prekur nga kjo paligjshmëri, si një e drejtë kushtetuese dhe ligjore që duhet ti garantohet çdo individ dhe subjekti nga organet shtetërore në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Në kërkesën tonë, kemi kërkuar edhe marrjen e masave ndaj drejtuesve të institucioneve të varësisë tuaj si, IMT, Policia Bashkiake dhe Ndërmarrja e Ujitjes dhe Kullimit, të cilët me mungesën e përgjigjes ndaj kërkesës të Institucionit të Avokatit të Popullit me shkresë Nr.K3/Sh-76-2 prot., datë 09.12.2016, kanë refuzuar të bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit, sikundër parashikohet në nenin 22/1 të Ligjit Nr. 8454 datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar.

Ndërmarrja e Ujitjes dhe Kullimit, Bashkia Fier, në përgjigje të kërkesës tonë të përsëritur, me shkresë Nr.318 prot., datë 17.07.2017 është drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, ku na informon se, nga ana e kësaj ndërmarrje pasi janë bërë verifikimet e duhura

në terren është kthyer përgjigje znj.Sh.M dhe 22 banorëve të tjerë në këtë lagje, duke bashkëngjitur kopjen e përgjigjes dërguar banorëve me shkresë Nr.213 prot., datë 04.11.2016. Por ndërkohë, në shkresën e saj konstatohet se, Ndërmarrja e Ujitjes dhe Kullimit nuk është përgjigjur kërkesës tonë dhe të banorëve, se cilat janë masat konkrete të përkohshme dhe ato afatgjata që janë ndërmarrë nga ky institucion prej vitit 2016 e në vijim për rregullimin dhe disiplinimin në tërësi të situatës të krijuar nga bllokimi i kanaleve që shërbejnë për ujitjen dhe kullimin e ujrave të kësaj zone.

Gjithashtu, në përgjigjen e saj drejtuar banorëve me shkresën Nr.213 prot., datë 04.11.2016, Ndërmarrja e Ujitjes dhe Kullimit, thekson se, nga verifikimi në terren dhe ballafaqimi me hartat e sistemit, **problemi i ngritur nga banorët qëndron**, duke argumentuar nga pikpamja teknike se kanalet që shërbejnë për shkarkimin e ujrave të lagjes “Afrim i Ri” në pjesë të vecanta janë të bllokuar dhe dëmtuar në vite nga mungesa e investimeve, si dhe nga ndërhyrjet e paligjshme të banorëve me kryerjen pa kriter të ndërtimeve pa leje, kryesisht vitet e fundit nga disa subjekte private. Në përfundim të kësaj përgjigje, Ndërmarrja e Ujitjes dhe Kullimit arrin në konkluzionin se: **“...Për kullimin e tokave bujqësore është e domosdoshme kthimi në gjëndjen fillestare të rreth 40 ml të pjesës fundore të kanalit F-1 dhe funksionimi i derdhjes së tij tek nënkalimi i Degës së Fierit, pasi vetëm kështu mund të funksionojë normalisht kanali F-12, në të cilat kullojnë ujrave të tokave bujqësore...”**.

Nga ana e Kryeinspektorit të IMT-së, në përgjigje të shkresës tonë, me shkresën e tij Nr.8621/3 prot., datë 21.07.2017, shpjegon faktin se, situata është krijuar nga ndërtimet pa kriter të kryera vite më parë në këtë zonë nga disa banorë, si dhe objektet që kanë shkaktuar këtë situatë janë në proces legalizimi, në pritje që zyra e ALUIZNI-t dega Fier, të bëjë kualifikimet ose skualifikimet në zbatim të ligjit për legalizimet. Po ashtu, në vijim të përgjigjes, IMT përmend faktin se, përsa i përket mureve rrethuese të ndërtuara në mënyrë të paligjshme mbi kolektorë të shkarkimit të ujrave dhe kanalit vaditës, **“...do të jenë objekt shqyrtimi i planit rregullues të zonës në fjalë, ku mbas mbarimit të procesit të legalizimeve, do të fillojë urbanizimi i gjithë zonës në fjalë, me kritere të qarta të përcaktuara në ligjet dhe rregulloret në fuqi në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës...”**.

Sa më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit nga një analizë konkrete bazuar në shqetësimin e prezantuar nga shtetasja Sh.M dhe 22 banorët e lagjes “Afrim i Ri” (SMT-ja), duke e ballafaquar me përgjigjet dhe konkluzionet e dërguara nga IMT dhe Ndërmarrja e Ujitjes dhe Kullimit në Bashkia Fier, në referencë të akteve ligjore dhe nënligjore lidhur me kompetencat e organit që ju përfaqësoni, si organi përfaqësues dhe ai ekzekutiv i njësisë të qeverisjes vendore, Bashkia Fier, si dhe akteve që rregullojnë kryerjen e procesit dhe procedurat e miratimit të lejeve të legalizimit të subjekteve vetëdeklaruese, evidentojmë se:

1. Në nenin 3/b të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, thuhet shprehimisht se, misioni i vetëqeverisjes vendore siguron qeverisjen e efektshme nëpërmjet: **“...b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera...”**. Në këtë kuadër përfshihet dhe respektimi i të drejtës të banorëve të lagjes “Afrim i Ri” (SMT-ja), ku siguria për jetën, shëndetin dhe pronat e ligjshme të këtyre banorëve, po cenohen si pasojë e kryerjes pa kriter të ndërtimeve pa leje nga disa subjekteve private mbi kolektorin kryesor të shkarkimit të

ujrave, bllokimit të tij dhe për pasojë përmbytjen e herë pas hershme të pasurive që disponojnë banorët në këtë zonë. Ndërkohë, mosveprimi i strukturave të ngarkuara me ligj si IMT, Policia Bashkiake dhe Ndërmarrja e Ujitjes dhe Kullimit në Bashkia Fier, në marrjen e disa masave tekniko organizative të përkohëshme për zgjidhjen e shqetësimit të banorëve, deri në marrjen e vendimit përfundimtarë nga ALUIZNI për statusin e këtyre objekteve është e pamjaftueshme, pasi ato nuk mund justifikohen vetëm me verifikimin dhe konstatimin e shqetësimit të banorëve, apo me faktin se këto ndërtime aktualisht janë në proces legalizimi pranë zyrës të ALUIZNI-t Fier. Ndërkohë, situata kaotike në të cilën ndodhen subjektet ankuese, si pasojë dhe mosveprimi të organeve shtetërore me mjete dhe mekanizma teknikë dhe ligjorë, kanë sjellin çdo ditë dëmtime të parikuperueshme në gjëndjen e pronave të ligjshme të tyre.

2. Në kuptim të Ligjit Nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, në nenin 9/b të tij, ku parashikohet e drejta dhe përgjegjësitë e njësisë të qeverisjes vendore, thuhet shprehimisht se: *“...b) bazuar në Kushtetutë, në ligje dhe aktet nënligjore, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre, për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave, nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra... ”*. Po ashtu, në vijim të po këtij ligji në nenin 27/1, në funksionet e Bashkisë në fushën e bujqësisë, parashikohet se: *“Bashkia ka përgjegjësi për: “...Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre... ”*. Në këtë kuadër, çdo vendim dhe veprim i organit që ju përfaqësoni dhe institucioneve të varësisë tuaj, për lirimin e hapsirave publike me qëllim zhbllokimin e këtyre kanaleve kulluese të ujërave, në mbrojtje të të drejtave të ligjshme të qytetarëve të cilëve po ju dëmtohen çdo ditë pronat e tyre, do të ishte plotësisht i justifikuar dhe i bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

### **I nderuar z. Kryetar,**

Në Ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”*, të ndryshuar dhe VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 *“Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”*, parashikohen qartë detyrat e njësisë të qeverisjes vendore, koordinimi i punës mes organeve shtetërore për mbarëvajtjen e këtij procesi, kriteret për kualifikimin dhe skualifikimin e ndërtimeve informale, si dhe procedurat për pezullimin e ndërtimeve pa leje në rastin kur ato nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet e mësipërme.

Kështu, në nenin 5 të këtij ligji përcaktohen detyrat e njësisë të qeverisjes vendore në këtë proces dhe më konkretisht në pikën “d” thuhet shprehimisht se: *“...d) bashkërendon punën, sipas rastit, me këshillin e qarkut, ALUIZNI-n, ministritë e linjës dhe KRRTRSH-në, për mbarëvajtjen dhe ecurinë e procesit të legalizimit, urbanizimit dhe integrimit të zonave informale... ”*. Gjithashtu, po në vijim të këtij ligji, në nenin 13/3, thuhet shprehimisht se: *“3. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, në bashkëpunim me Policinë e Ndërtimit, merr masa të posaçme për parandalimin e ngritjes së ndërtimeve të reja në këto zona... ”*.

Pra, kjo nënkupton se përgjegjësia e organit që ju përfaqësoni, sëbashku me institucionet e ngarkuara me ligj në varësinë tuaj, është të bashkërendojë punën gjatë gjithë procesit me

këto institucione, të ndërhyjë për parandalimin e tyre, si dhe të njoftojë me shkrim të gjitha rastet e paligjshmërisë të këtyre ndërtimeve pa leje brënda territorit që administrohet nga ana juaj. Njëkohësisht, ligji parashikon dhe të drejtën e organit tuaj për të bërë propozime për skualifikimin e subjekteve nga e drejta e pajisjes me leje legalizimi, kur objektet nuk plotësojnë kriteret për ndërtimin e tyre, si në rastin e ndërtimeve pa leje të kryera mbi kolektorin kryesor të shkarkimit të ujrave dhe kanalën vaditës në lagjen “Afrim i Ri” (SMT-ja), Rruga e Semanit.

Po ashtu, në VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 *“Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”,* në kreun III, në kriteret për legalizimin e ndërtimeve jashtë zonave informale të miratuara, pika 4/e, thuhet shprehimisht se: *“Ndërtimi informal i llojit "objekt", i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, dhe që është ngritur jashtë vijës kufizuese të zonës informale të miratuar, përjashtohet nga legalizimi kur: e) është ngritur brenda brezit mbrojtës të sistemeve kryesore të kullimit, të mbrojtura sipas ligjit nr. 8518, datë 30.7.1999, "Për ujëtimin dhe kullimin", të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij...”*, pra kur objekti është ngritur në zonat me rrezik përmblyjeje, çarje apo dhe rrëshqitjeje.

**Nga sa përmendëm më lartë, konkluzioni i Institucioni i Avokatit të Popullit nga trajtimi i çështjes të lartëpërmendur, në kuptim dhe të përcaktimeve ligjore në fuqi, është se banorëve të lagjes “Afrim i Ri” (SMT-ja), Rruga e Semanit, janë cënuar interesat e tyre të ligjshme, përsa i takon të drejtës për sigurinë e jetës të familjeve dhe të drejtave që rrjedhin nga pronësia e tyre e ligjshme, nga veprimet e disa subjekteve private që kanë ndërtuar pa kriter mbi kolektorin kryesor të shkarkimit të ujrave dhe kanalën vaditës të kësaj zone.**

**Ndërkohë, ju bëjmë me dije se, vazhdimi i dëmtimit çdo ditë të pronave të ligjshme të këtyre banorëve, për shkak të mosveprimit të organit shtetëror të ngarkuar me ligj, në rastin konkret Bashkia Fier, për parandalimin e këtyre ndërtimeve apo marrjen e masave të përkohëshme për rregullimin e disiplinimin e situatës të kullimit të ujrave të kësaj zone, përbën një dëm pasuror jashtëkontraktorë të parashikuar në Ligjin nr. 8510, date 15. 7. 1999 *“Për pergjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”,* dëm ky që vazhdon të rritet me kosto të lartë financiare mbi Institucionin që ju drejtoni.**

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 21/b, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”,* i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se: *“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit....., paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,*

## **REKOMANDOJMË**

1. Veprimin e menjëhershëm të Bashkisë Fier në bashkërendimin e punës me Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t, Fier dhe institucionet e tjera shtetërore të përfshira në këtë proces, në bazë të informacioneve të konstatuara dhe vërtetuara edhe nga ana e organit të

qeverisjes vendore, Bashkia Fier, të merren masa për përjashtimin nga legalizimi të ndërtimeve pa leje të ndërtuara mbi kolektorin kryesor të shkarkimit të ujrave dhe kanalin vaditës në lagjen “Afrimi i Ri” (SMT-ja), rruga e Semanit, Fier, pasi ato janë bërë shkak për bllokimin e shkarkimit të urjave në këtë zonë, daljen e ujrave në sipërfaqe, duke përmbytur dhe dëmtuar pronat e ligjshme të 22 subjekteve të përmendura në ankesë, si dhe me pasoja në ndotjen e ambientin dhe sigurinë e jetës dhe shëndetit të këtyre banorëve.

2. Marrjen e masave teknike dhe ligjore për dhënien e një zgjidhje të përkohshme të shqetësimit të banorëve të kësaj zone, deri në sqarimin dhe vlerësimin përfundimtarë të statusit të këtyre objekteve informale, nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Fier.

3. Hartimi dhe miratimi i një projekti të vecantë për rehabilitimin e kësaj zone dhe vënien në efecencë të kolektorit kryesor të shkarkimit të ujrave dhe sistemin e kalanalizimit që përshkajnë këtë zonë, si dhe miratimin e një fondi të veçantë në Këshillin Bashkiak Fier, për përballimin e këtij investimi.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë kopje të ankesës dhe të përgjigjeve të institucioneve në varësinë e Bashkisë Fier, për trajtimin e kësaj ankese.

*Duke besuar në bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONER**

**Arben SHKËMBI**